

NATASHA KAZMAJ (KALEMI)

**VËSHTRIM KRAHASUES RRETH DISA KONCEPTEVE TË
SINTAKSËS TRADICIONALE DHE SINTAKSËS GJENERATIVE**

Dihet që sintaksa (sipas konceptit tradicional), është ajo pjesë e gramatikës, që studion mënyrat se si lidhen fjalët në togfjalësha ose në fjali dhe vetë fjalitë ndërmjet tyre, shih (*Fjalori gjuhës shqipe*) apo e thënë më qartë “*Sintaksë quhet tërësia e mënyrave të bashkimit në ligjërim të fjalëve të një gjuhe sipas kuptimit të natyrës gramatikore dhe marrëdhëniet e vendosura midis njësive të formuara prej tyre*” (shih *Gramatika e gjuhës shqipe* 2)

Nga objekti i studimit të saj mund të themi se të dy drejtimet e sintaksës, si ajo tradicionale dhe ajo gjenerativiste në këtë pikë përputhen. Mirëpo aty ku takohen të dy drejtimet, aty fillon dhe dallimi mes tyre. Kështu, vërtet sintaksa tradicionale e sheh lidhjen mes fjalëve për nga funksioni që ato kryejnë në fjali, pa hyrë thellë në raportet që ekzistojnë mes fjalëve që hyjnë në lidhje mes tyre, pra pa parë çfarë lloj marrëdhënieje, lineare apo hierarkike ka mes tyre konkretisht, edhe nëse i specifikon ato në lidhje barazie ose varësie.

Pra sintaksa gjenerative duke mos u marrë vetëm me atë që sintaksa tradicionale e studion thellësisht, funksionin e fjalëve, ajo studion... “1. *Se si paraqitet struktura e sintaksës së gjuhëve njerëzore e përbërë nga njësi diskrete, po të kombinuara mes tyre... dhe 2. pse dhe si ndodh lëvizja e tyre...*” (shih “Ç’është gramatika gjenerative”, Giorgio Graffi, Toena, 2010) pra merret me mënyrën e lidhjes së fjalëve, duke u futur thellë në marrëdhëniet e barazisë apo të varësisë që ato krijojnë dhe në faktin se sa e domosdoshme është prania e një fjale si valencë e një fjale tjetër pa u marrë gjatë me funksionin e saj dhe duke e parë në të njëjtën vlerë rëndësie në ndërtimin e sintagmës edhe përcaktorin edhe kundrinorin, pra ato më tepër shihen se sa të domosdoshme janë në kumtim, gjë që e shprehin në vendosjen e fjalëve të një sintagme në skemën X(bar).

Duke u ndalur si në lidhjet e fjalëve brenda një fjalie dhe të fjalive të veçanta brenda një periudhe, vërehet se këto dy sintaksa ndajnë pikëpamje të ndryshme rreth varësisë së fjalëve nga njëra-tjetra dhe varësisë që ekziston mes fjalive të një periudhe.

Kështu në studimin e lidhjeve mes fjalive të periudhave të ndryshme, sintaksa tradicionale sheh në lidhje bashkërenditëse, ato fjali që brenda një periudhe janë të pavarura mes tyre dhe që lidhen zakonisht me lidhëzat bashkërenditëse (ose pa lidhëza) (shih *Gramatika e gjuhës shqipe* 2, f. 442)

Sipas studimit më të thelluar që sintaksa gjenerative i bën fjalive brenda një periudhe, sheh më konkretisht sesa të varura janë ato fjali mes tyre, duke

theksuar faktin se periudhat me fjali të varura në të vërtetë janë ato ku folja, si bërthamë e fjalisë, apo e tërë fjalia kryesore në një periudhë të përbërë nuk ka një kuptim të plotësuar dhe kërkon “valencat” e saj për t’u plotësuar (për termin “valencë” shih Graffi, G., *Sintaksa. Strukturat e ligjëritimit*, Dituria 2003, f. 62, *Hyrje në sintaksën gjenerative të shqipes*, F. Koleci, G. Turano Tiranë 2011, f. 33).

Dhe kështu mes fjalive fthilluese dhe atyre rrethore sheh si mirëfilli të varura fjalitë fthilluese (kryefjalore ose kundrinore qofshin ato) në të cilat valencat e foljes në fjalinë kryesore janë të paplotësuara.

Dihet se mali ngjitet në mëngjes.

Menduam që malin ta ngjisim në mëngjes. (në asnjë nga fjalitë nuk mund të hiqet pjesa e nënrenditur sepse fjalia nuk ka më kuptim, është e paplotë.)

Përsa i përket periudhave me fjali të varura rrethore, ndonëse vendosin marrëdhënie rrethore me fjalinë kryesore, ato janë në rolin e një adjunkti. Nëse do të merrnim në konsideratë që sintagmat sipas sintaksës gjenerative janë të përbëra nga koka, specifikuuesi, komplementi, adjunktët dhe modifikuesit. Dihet që ajo sheh si elemente të domosdoshme të kokës, komplementin dhe specifikuuesin duke mos parë si të domosdoshëm adjunktët fakt ky, i njohur dhe në sintaksën tradicionale (për rrethorët).

Ne iu ngjitëm malit në mëngjes.

Ne iu ngjitëm malit kur u bë mëngjes. (nëse periudhës i hiqet fjalia rrethore ajo mund të ekzistojë si fjali e thjeshtë)

Nëse do t’i takonim të dy sintaksat në këtë pikë mund t’i jepet një lloj shpjegimi, se përse fjalitë rrethore nuk shihen si plotësisht të nënrenditura në sintaksën gjenerative. Sipas sintaksës tradicionale që një fjali të ekzistojë ka si gjymtyrë kryesore kryefjalën dhe kallëzuesin, gjymtyrë te dyta të domosdoshme kundrinorin e drejtë dhe kundrinorin e zhdrejtë pa parafjalë dhe si gjymtyrë të dyta jo të domosdoshme, kundrinorët e zhdrejtë me parafjalë dhe rrethorët.

Kështu sintaksa gjenerative në paraqitjen e saj skematike ka tri elemente në skemën X(Bar): **Kokë – komplement- specifikuues dhe adjuntët e modifikuesit ku “... koka e një sintagme është elementi qendror dhe i domosdoshëm për projektimin e një sintagme” dhe “...Çdo sintagmë ka përveç kokës edhe komplementin duke formuar një përbërës që qëndron në nivel më lart, i cili paraprihet nga specifikuuesi”** (shih *Hyrje në sintaksën gjenerative të shqipes*, F. Koleci dhe G. Turano) për të plotësuar skemën.

Duke i parë fjalitë rrethore në funksionin e një adjunkti që e plotëson por nuk rrezikon ekzistencën e skemës X (Bar) (apo dhe të vetë fjalisë si dhe e kemi thënë më parë) ajo lëviz lirshëm dhe nuk hyn në marrëdhënie varësie me fjalinë kryesore si ajo kryefjalore e kundrinore por në marrëdhënie më të pavarura prej saj. Por duhet vërejtur se në strukturën sintagmatike nuk mund të zëvendësohet vendi i një adjunkti me atë të fjalisë rrethore, siç vepohet në

fjalitë kryefjalore e kundrinore që zënë vendin e specifikuesit dhe të komplementit në skemën X (Bar) ose ashtu sikurse në veprojë lehtësisht për të zëvendësuar një rrethanor me një pjesë të nënrenditur rrethanore në sintaksën tradicionale.

Ne erdhëm në shtëpi në mëngjes

Ne erdhëm ku ndodhej shtëpia, kur u bë mëngjes.

Shembuj të kësaj natyre mund të krijojmë mjaftueshëm për të thënë se nëse në sintaksën tradicionale një pjesë e nënrenditur luan për pjesën kryesore atë rol që luan dhe rrethanori në fjalinë e thjeshtë një fakt i tillë në sintaksën gjenerative nuk mund të barazohet plotësisht por përkundrazi të marrë një drejtim tjetër megjithëse edhe në paraqitjen skematike një fjali e thjeshtë nuk mund të paraqitet në skemë si fjalia e përbërë edhe sipas sintaksës tradicionale. Por mund të themi që nëse në sintaksën tradicionale e vetmja skemë e paraqitjes për fjalinë e thjeshtë është vetëm ajo lineare e tipit KR + KALL + KUND DR + RRETH etj.

(Ne pamë peshq në det.) ku kemi ta bëjmë me një fjali klasike dhe sërish lineare jepet skema edhe nëse vendosja e gjymtyrëve është e çrregullt e jo në modelin klasik

(Në det peshq pamë ne.) RR + KD + KALL + KR

Përsa i përket sintaksës gjenerative ajo në paraqitjen skematike të saj, shpjegon të tëra lidhjet që gjymtyrët vendosin në mënyrë hierarkike mes tyre, pavarësisht rendit të vendosjes së tyre në fjali.

Nuk duhet parë krejt i rastësishëm dhe ky shembull në tekstin “Gjuha shqipe 9”, “Albas” Ushtrimi 4 f. 250, ku fjalitë e përbëra bashkërenditëse kërkohen të kthehen në nënrenditëse rrethanore dhe anasjelltas.

Por në këtë rast është i paspecifikuar lloji i fjalisë nënrenditëse rrethanore që do krijohet dhe vërejmë se ajo mund të pranojë variante nga më të ndryshmet.

1. *Rashë në gjunjë dhe e putha tim atë në ballë*

Ne mund të krijojmë lehtësisht këto fjali

1.a. *Rashë në gjunjë që të puthja tim atë në ballë*

1.b. *Rashë në gjunjë sepse putha tim atë në ballë*

1.c. *Rashë në gjunjë kur putha tim atë në ballë*

Ose në variantin:

Kur rashë në gjunjë, putha tim atë në ballë.

2. *Nata ishte me hënë të plotë dhe gjithë vendi llapiste si në mes të ditës*

2.a. *Gjithë vendi llapiste si në mes të ditës kur nata ishte me hënë të plotë.*

2.c. *Gjithë vendi llapiste si në mes të ditës pasi nata ishte me hënë të plotë*


2.b. *Gjithë vendi llapiste si në mes të ditës sepse mata ishte me hënë të plotë*

etj.


Le të shikojmë skemat e dy periudhave, një me dy fjali bashkërenditëse dhe një me fjali të nënrenditur rrethanore sipas të dy sintaksave, asaj

tradicionale dhe asaj gjenerative për të ilustruar shembujt e mësipërm dhe bërë dallimin mes tyre.

Sipas sintaksës tradicionale kemi këto skema:



Dhe sipas sintaksës gjenerative kemi këtë paraqitje skematike.



Për një përjasje më të thelluar do ndalemi pak në konceptet e togfjalëshit dhe sintagmës, dhe më konkretisht të atyre emërore.

Sipas veprës së Graffi termi “Sintagmë” ose “grup fjalësh” (togfjalësh) janë përbërësit e fjalisë (shih Graffi, G., *Sintaksa. Strukturat e ligjëritimit*. Dituria, 2003, f. 97)

Pavarësisht emërimit duket se janë e njëjta gjë, por që në fakt nuk rezulton si e tillë nëse hymë në analizën e ndërtimit të tyre. Në sintaksën tradicionale togfjalëshi është “*njësia sintaksore strukturore e përfutur gjatë ligjëritimit nga bashkimi gramatikor dhe kuptimor i dy ose më shumë fjalëve kuptimplota të bashkuara në lidhjen e nënrenditjes që tregon marrëdhënie mes dukurive, proceseve, tipareve etj.*” (shih *Gramatika e gjuhës shqipe II*, botimi Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë) pra pranohet që fjalët formojnë togfjalësh vetëm kur fjalët që vendosin lidhje mes tyre janë të mëvetësishme dhe kuptimplota, duke mos pranuar si togfjalësh lidhjen *parafjalë + emër*, përveç kur këto të fundit shihen si një komponent i vetëm në gjymtyrën e një togfjalëshi që ka si bërthamë një fjalë tjetër ose shihen si një bërthamë e vetme që duhet shoqëruar me një tjetër fjalë të mëvetësishme për të qenë togfjalësh.

Tek koncepti i togfjalëshit sipas sintaksës tradicionale, nuk i jepet vlere si fjalë drejtuese parafjalës por shihet si fjalë shërbyese me kuptim leksikor të kushtëzuar (shih *Gramatika e gjuhës shqipe* I, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, f. 382) dhe nuk përfshihet si fjalë drejtuese e një togfjalëshi por së bashku me emrin jep një togfjalësh emëror. Duke iu referuar kësaj sintakse fjala drejtuese emërtohet ndryshe “fjalë bosht” dhe llojet e togfjalëshit janë: **emërorë, foljorë, mbiemërorë, numërorë, përemërorë, ndajfoljorë**.

Ndërkohë sintaksa gjenerative i sheh si dy elemente që mund të formojnë një sintagmë edhe parafjalën dhe emrin dhe i emërton ato në varësi të fjalës që arrin të jetë fjalë drejtuese. Kështu llojet e përbërësve ose të sintagmave sipas saj janë:

Emërore, foljore, mbiemërore, parafjalore duke lënë jashtë fjalës “kokë” në një sintagmë përemrat dhe numërorët dhe duke i parë këta të fundit më tepër në rol specifikuesi (f. 62, Graffi, G., *Sintaksa. Strukturat e ligjëritimit*. Dituria, 2003).

Tek koncepti i togfjalëshit sipas sintaksës tradicionale, nuk i jepet vlere si fjalë drejtuese parafjalës por shihet si fjalë shërbyese së bashku me lidhëzat, si kategori gramatikore–funktionale që nuk përfshihet si fjalë drejtuese e një togfjalëshi por së bashku me emrin jep një togfjalësh emëror. Duke iu referuar kësaj sintakse fjala drejtuese emërtohet ndryshe “fjalë bosht”.

Duke ndaluar në sintagmën emërore ose togfjalëshin emëror, sipas sintaksës tradicionale në togfjalëshin emëror duket se gjymtyra plotësuese e emrit kryen të njëjtin funksion për bërthamën, atë të përcaktorit pavarësisht lidhjes që ekziston mes tyre, me përshtatje, me bashkim apo me drejtim.

Në sintaksën gjenerative sintagma emërore, ku fjala drejtuese është sërish një emër, fjala që shërben si plotës apo si përcaktor i saj vendos lidhje të ndryshme hierarkike me të. Kështu do vëmë re në shembujt ilustrues, se koka mban të njëjtin pozicion në skemën X(Bar), pra përcaktori, pavarësisht lidhjeve që vendos me emrin bërthamë, mund të marrë pozicione të ndryshme në skemën X(Bar) dhe për më tepër në sintaksën tradicionale këto ndërtime shihen vetëm si lineare dhe në lidhje me emrin bërthamë mund të qëndrojnë para ose pas tij.

Kjo këngë e bukur

E bukur kjo këngë

Nëse do t'i shohim shembujt në skemën X(bar) pozicionimi i përcaktorit në fjali në lidhje me fjalën bërthamë (para apo pas saj) nuk luan rol në pozicionimin e tij në këtë skemë.


1. *Ajo këngë e bukur.*

Këngë (bërthama (koka) (fjala drejtuese)

Ajo dhe **e bukur** të dy përcaktorë me përshtatje. Skema x (bar) ka gjithmonë tri elemente.


Kjo lidhje treshe nuk vërehet në sintaksën tradicionale, ndërsa në sintaksën gjenerative, pavarësisht shprehjes ose jo të elementeve, skema është me tri elemente.

Ajo dhe **e bukur** të dy kanë lidhje përshtatjeje me bërthamën por vende të ndryshme në skemën x(bar)




2. Çdo këngë e bukur.

Çdo dhe **e bukur** janë në lidhje bashkimi (çdo) dhe përshtatje (e bukur) ruajnë të njëjtat vende si më lart në skemën x (bar)




3. Ajo këngë burrash.

Ajo dhe **burrash** janë të dy përcaktorë por vendi në skemën x(bar) ndryshon nga skema më lart dhe si vërehet nuk merret parasysh lidhja me përshtatje apo me drejtim mes përcaktorëve dhe emrit bërthamë.




4. Ajo këngë burrash me lahutë

Ajo, **burrash** dhe **në male** të tre përcaktorë për emrin kokë. **Burrash** dhe **në male** të dy përcaktorë me drejtim por me vende të ndryshme në skemën x(bar)



5. Mu në këngën e re.

Si dhe do ta shikojmë në këtë shembull sintaksa gjenerative mbush të tëra boshllëqet e sintaksës tradicionale pa përjashtim, pa lënë asnjë klasë fjalësh jashtë nga lidhjet që krijon me fjalët e tjera. Ndërkohë sintaksa tradicionale le disi jashtë lidhjeve, pra pa një funksion të përcaktuar qartë, fjalë si pjesëzat, nyjet joshqese e parafjalët, të cilat në skemën x (bar) të sintaksës gjenerative gjejnë vendin e tyre.



Në vazhdim mbetet që teoria e gramatikës universale dhe gramatika gjenerative të marrin një njohje më të gjerë për të plotësuar hapësirat boshe në sintaksën tradicionale.

BIBLIOGRAFI

- F. Koleci, G. Turano, *Hyrje në sintaksën gjenerative të shqipes*, Tiranë, 2011.
 Fjalori i gjuhës shqipe, Tiranë, 1984.
 G. Graffi, *Ç'është sintaksa gjenerative*, Toena, 2010.
 G. Graffi, *Sintaksa. Struktura e ligjërit*, Dituria, 2003.
Gramatika e gjuhës shqipe I, Akademia e Shkencave, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1995.
Gramatika e gjuhës shqipe II, Akademia e Shkencave, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2012.
Gjuha shqipe 9, Albas, Tiranë, 2010.

